



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJERAVE DHE
SHËRBIMIT VETERINAR

Berat , më ____ . ____ .2023

RELACION

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË PYLLIT
Në zbatim ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Bazuar në ligjin nr 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

1. Dokumentacioni dhe procedura e ndjekur.

Specialistët e pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimi i Pyjeve , Ujërave dhe shërbimi veterinar- bashkia berat kanë hartuar planin e parandalimit dhe menaxhimit të zjarreve për vitin 2023.

Është ndërtuar skema e lajmërimit në rast zjarri

Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:

- 1. Kopje të planit të masave per parandalimin e zjarreve për vitin 2023.**
- 2. Për diskutim: Miratimin paraparak të planit të masave parandaluese të zjarreve për vitin 2023.**

Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të meren vendimet:

1.Të miratojë planin e masave parandaluese të zjarreve për vitin 2023.

2.Për zbatimin e këtij Vendimi dhe vazhdimin e procedurave të ngarkohet Sektori i Pyjeve .

Drejtori

Arjan Shkëmbi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

**DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE TRANSPORTIT DHE PRONAVE
RELACION**

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO - LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILËVE JANE DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISE I VITIT 2022, PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE

Tënderuar këshilltarë,

Në datën 29.01.2023 nga zjarri I rënë u dëmtuan 2 banesa ndodhur në Lagjen “ Çlirim “ ; Lagja 1, Bashkia Berat .

Pas arkivimit të kërkesave të shtetasve Pëllumb Dervishi dt.31.01.2023, dhe shtetasi Elion Zani datë 30.01.2023, Komisioni i Emergjencave i ngritur me Urdhërin Nr.54 datë 31.01.2023 dhe Nr.55 date 31.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë , shkoi në vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi proces verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Per kriteret per procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “. Proces verbalet e konstatimit u percollën në Këshillin e Qarkut me shkresat Nr.717 Prot, date 07.02.2023 dhe Nr.718 Prot, date 07.02.2023 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut, ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesat e z. Pellumb Dervishi e Z. Elion Zani dhe janë përcjellë në Bashkinë Berat me Nr. 175/2 Prot, datë 20.02.2023; Nr. 175/3 Prot, datë 20.02.2023.

Në mbështetje të preventivave të hartuara nga grupi i ekspertëve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet :

1. Në banesën e shtetasit Pëllumb Dervishi vlerën	413328 lek .
- Punime ndërtimore në vlerën	186328 lek
- Orendi dhe pajisje “	227000 lek
2. Në banesën e shtetasit Elion Zani vlerën	185088 lek .
- Punime ndërtimore në vlerën	35088 lek
- Orendi dhe pajisje “	150000 lek

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë, në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 shkronjen “ ç”, të pikës 1, të kreut III; i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:

Z. Pëllumb Dervishi në vlerën	206 664 leke
Z. Elion Zani në vlerën	92 544 leke
Totali	299 208 leke

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkoheshme të jetesës , si dhe për shpenzime të tjera për përballimin e situatës emergjente .

DREJTORI DMCTP

Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

RELACION

MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2024-2026

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Kalendarit Buxhetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak në muajin Dhjetor 2022 me VKB nr 101 datë 22.12.2022, po ju paraqesim për miratim tavanet përgatitore të PBA 2024-2026.

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë udhëzim nr. 6 datë 28.02.2023 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2024-2026”, i cili përmban:

- a) tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026;
- b) informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- c) procedurat dhe afatet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2024-2026;
- d) mënyrën e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) instrumentin e planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në Udhëzimin nr. 6 datë 28.02.2023 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2024-2026”, pika I, 16, cilsohet se Bashkia Berat, së bashku me bashkitë Korçë, Gjirokastër, Mirditë, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnje, Përmet, do të përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 bazuar në metodologjinë e re sipas shtojcës 5, bashkëlidhur udhëzimit.

Metodologjia e re mbështetet në katër kritere të rëndësishme:

- a) Struktura e programeve buxhetore të NJVQV-ve pilot bazohet në strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve të NJVQV-ve (por nuk njihsohet domosdoshmërisht me to) .
- b) Ruajtja e raportimit funksional të shpenzimeve për 36 klasa të nivelit të 3-të të COFOG.
- c) Heqja e detyrimit të NJVQV-ve për të patur deri në 20 programe (të bazuara në nivelin 3 COFOG), 20 Ekiye të Menaxhimit të Programit dhe 20 DEMP.
- d) Ruajtja e një numri të menaxhueshëm të programeve buxhetore, duke shmangur problematikën e numrit shumë të madh të programeve të vogla që aktualisht përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Parimet themelore të metodologjisë së re, që do të zbatohet gjatë vitit 2023 nga këto nëntë NJVQV janë:

- a) Shkëputja e dimensionit të funksionit nga ai i programit për raportimin funksional të shpenzimeve. Funksioni do të identifikohet tashmë përmes kodit të produktit (dhe jo kodit të programit) për raportimin fiskal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

- b) Lejimi i NJVQV-ve që të krijojnë programe buxhetore të ngjashme me strukturat e menaxhimit të shërbimeve:
- Kodet për programet e reja të jenë të ndryshme dhe të dallueshme nga kodet e programeve të vjetra të NJVQV-ve (shiko më poshtë Seksionin e fundit të kësaj shtojce).
 - Kodet e reja në planin e llogarive për programet e reja do të përfshihen në përgatitjen e buxhetit të NJVQV-ve dhe në sistemin e thesarit për qëllime të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.
- c) Kodet e produkteve do të mundësojnë raportim të saktë fiskal kundrejt nivelit të 3-të të COFOG (36 funksioneve të qeverisjes vendore).
- d) Dimensioni i funksionit do të përdoret vetëm për raportim dhe raportimi funksional i shpenzimeve do të kryhet përmes kodit të produktit, përcaktuar si më poshtë në shtojcë.
- e) Përgatitja dhe Zbatimi i Buxhetit të Vitit 2024 për këto nëntë bashki do të bëhet në nivel produkti, krahas klasifikimeve të tjera buxhetore të përcaktuara me ligj.

Bazuar në metodologjinë e re për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit:

- a) Drejtuesit e programeve të NJVQV, në vitin 2024, do të menaxhojnë zbatimin e një vëllimi më të madh burimesh financiare që më parë ishin të fragmentuara në një numër të madh programesh të bazuara në nivelin 3 të COFOG.
- b) Madhësia mesatare e buxhetit të programeve individuale do të rritet, duke u lejuar drejtuesve më shumë fleksibilitet në zbatim, në përgjigje të ngjarjeve të paparashikuara dhe të paparashikueshme
- c) Kjo përmirëson ndjeshëm mundësinë për të planifikuar dhe shpërndarë burimet në mënyrë korrekte për programet dhe produktet në përgatitjen e PBA 2024-2026 dhe në përgatitjen e Buxhetit të Vitit 2024. NJVQV-të duhet të përmirësojnë procesin e buxhetimit nëpërmjet:
- d) Finalizimit të kujdesshëm i produkteve të PBA 2024-2026.
- e) Përfshirja e produkteve të vitit 2024 të PBA 2024-2026 në Buxhetin e Vitit 2024.
- f) Rishikimi i produkteve të vitit 2024 në dokumentin e PBA-së 2024-2026 në përgjigje të çdo udhëzimi të Këshillit Bashkiak për ndryshimin e produkteve të Buxhetit të Vitit 2024.

I. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026, në nivel programi buxhetor.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2024-2026 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 27.01.2023, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026. Kuadri makroekonomik e fiskal pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme. Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2024-2026 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor në fuqi.
- Transferta e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2024-2026, së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, financon funksionet dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2021. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar është 1.01 % e PBB-së së viteve 2024-2026 (shtojca 1 e udhëzimit). Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2024-2026 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Në përlllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2023, kriteret e përdorura dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2024-2026 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km², numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme :

o Për vitin 2024 , shuma 390,203 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2023 transferta është parashikuar me rritje + 20,315 mijë lekë, ose +5.5%.

o Për vitin 2025 , shuma 412,307 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2024 transferta është parashikuar me rritje + 22,104 mijë lekë, ose +5.7%.

o Për vitin 2026 , shuma 436,821 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2025 transferta është parashikuar me rritje + 24,514 mijë lekë, ose +5.9%.

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme për bashkinë Berat për periudhën 2024-2026

në 000 lekë

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme , Bashkia BERAT	298,960	308,280	369,888	390,203	412,307	436,821
Krahasimi me vitin paraardhës						
shtesa në vlerë	5,861	9,319	61,608	20,315	22,104	24,514
shtesa në %	2.0%	3.1%	20.0%	5.5%	5.7%	5.9%

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për cdo funksion të transferuar.

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2024-2026, do të jetë 1% më e lartë për cdo vit buxhetor.

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkinë Berat për periudhën 2024-2026

në 000 lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Mbrotja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	31,466	32,725	34,313	34,656	35,003	35,353
Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit	15,095	15,699	16,106	16,267	16,430	16,594
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	5,666	5,893	6,103	6,164	6,226	6,288
Rrjeti Rrugor Rural	4,824	5,228	5,374	5,428	5,482	5,537
Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	136,006	149,491	156,251	157,814	159,392	160,986
Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	41,360	42,211	43,555	43,991	44,430	44,875
Mbrojtja sociale (Qendra LIRA)	23,731	23,984	24,703	24,950	25,200	25,452
Total Transf. e pakushtëzuar sektoriale	258,148	275,230	286,405	289,269	292,162	295,083
Krahasimi me vitin paraardhës						
shtesa në vlerë	4,186	17,082	11,175	2,864	2,893	2,922
shtesa në %	1.6%	6.6%	4.1%	1.0%	1.0%	1.0%

Transferta e kushtëzuar

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si burim financimi i funksioneve të bashkisë, për periudhën 2024-2026 parashikohen të jenë :
për vitin 2024 parashikohen të jenë 590,530 mijë lekë, për vitin 2025 parashikohen të jenë 600,731 mijë lekë, me rritje +10,201 mijë lekë në krahasim me vitin 2024 ose +1.7% ;
për vitin 2026 parashikohen të jenë 612,746 mijë lekë, rritje + 12,015 mijë lekë në krahasim me vitin 2025 ose +1.7%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Të ardhurat Vendore (taksa&tarifa vendore)

në mijë lekë

Nr	Emertimi/Muaji	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2023	Plani 2024	Plani 2025	Plani 2026
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	5,447	960	5,200	5,356	5,600	5,712
II	Taksa mbi te ardhurat personale	17,245	19,478	8,000	8,240	8,520	8,690
III	Taksat vendore	171,218	200,253	216,098	219,150	226,347	233,261
1	Takse tablele	2,764	2,382	2,529	2,990	3,079	3,141
•	Tabelë për qëllime identifikimi	1,951	1,822	1,948	2,107	2,170	2,213
•	Tabelë për qëllime reklamimi	813	560	582	883	910	928
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	10,712	10,706	16,364	17,922	19,030	19,411
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	53,850	76,161	79,982	79,500	79,903	83,888
4	Takse fjetje ne hotel	1,274	5,500	6,004	4,120	4,700	4,794
5	Takse mbi token bujqesore	13,942	13,985	18,555	19,695	20,285	20,691
6	Takse e mjeteve te perdorura	33,404	33,674	30,179	31,084	32,017	32,657
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë	3,299	3,567	3,090	3,183	3,278	3,344
8	Takse mbi ndertesat	45,328	47,279	51,912	52,840	56,002	57,122
9	Takse Trualli	6,644	7,001	7,482	7,817	8,052	8,213
10	Te tjera taksa lokale	-	-	-	-	-	-
IV	Tarifat vendore	156,493	175,008	226,089	232,283	233,042	233,626
1	Tarife e pastrimit	78,589	85,714	104,777	104,777	104,777	104,777
2	Tarife e ndriçimit publik	34,004	38,009	47,683	47,683	47,683	47,683
3	Tarife gjelberimi publik	27,976	31,376	40,250	40,250	40,250	40,250
4	Tarife Arsimi	9,339	8,452	11,135	11,135	11,135	11,135
5	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	-	-	-	-	-	-
6	Tarifa urbanistike	-	-	18	-	-	-
7	Tarifa te sherbimit administrativ	22	-	-	-	-	-
8	Tarife per license/certifikate ne fushen e	2,938	2,084	5,273	10,102	10,405	10,614
9	Tarifa per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	-	-	24	27	27	28
10	Tarifa te sherbimit te varrimit	-	6,728	9,526	9,800	10,000	10,200
11	Tarife per lende drusore	10	164	2,411	3,289	3,387	3,455
12	Tarife Ujitje	2,162	1,758	3,150	3,607	3,715	3,790
13	Tarife ambienti	690	230	1,021	785	809	825
14	Tarife therje	314	-	-	-	-	-
15	Te tjera tarifa	-	-	-	-	-	-
16	Taksa e rentës minerare	-	-	40	-	-	-
17	Tarife Urbanistike (kablloret)	450	494	780	828	852	869
V	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	10,977	13,324	20,010	22,225	22,892	23,350
1	Te ardhura nga konviktet	235	522	861	904	932	950
2	Te ardhura nga cerdhet	2,656	3,214	2,896	3,296	3,395	3,463
3	Te ardhura nga kopshtet	8,087	9,587	16,253	18,025	18,566	18,937
VI	Te ardhura te tjera	41,037	45,512	150,794	103,275	104,330	108,107
1	Te ardhura nga parkimi	3,858	4,571	4,332	4,646	4,785	4,881
2	Te ardhura nga qerate	25,124	31,374	30,778	21,900	21,900	25,400
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	-	-	-	-	-	-
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	-	2,086	62,986	31,300	32,239	32,884
5	Te tjera debitore dhe gjyqe	4,009	4,278	3,000	4,095	4,510	4,600
6	Debitore Biznes + Familje	7,567	2,432	48,341	41,000	40,551	39,991
7	Banesat Sociale + Enti	-	-	-	-	-	-
VII	Te ardhura nga MZSH	479	377	324	334	344	351
VIII	Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja	-	-	1,033	-	-	-
IX	Grante te huaja pa planifikuar	9,817	-	-	-	-	-
X	Te ardhura nga shitje mallra (skrap)	-	395	-	-	-	-
TOTAL		402,418	454,534	626,191	590,530	600,731	612,746
TOTAL + Grantin e pa planifikuar		412,235	454,534	626,191	590,530	600,731	612,746



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Bashkia Berat përgatiti planin financiar të periudhës afatmesme dhe tavanet përgatitore të PBA 2024-2026.

Në përfundim, parashikimi i taveve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, që do të shërbejnë për procesin e planifikimit të shpenzimeve, është si më poshtë:

Tavanet e të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024 – 2026

në mijë lekë

Burimi i Financimit		2023	2024	2025	2026
1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	369,888	390,203	412,307	436,821
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	286,405	289,269	292,162	295,083
3	Të ardhurat e veta	588,231	590,530	600,731	612,746
3.1	<i>Te ardhura nga taksa&tarifa vendore</i>	550,271	590,530	600,731	612,746
3.2	<i>Të ardhura të pritshme nga financimi i përkohshëm i projekteve të huaja</i>	37,960	-	-	-
Total fonde te parashikuara		1,282,484	1,270,002	1,305,200	1,344,650

TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026

në mijë lekë

Kodi i Programit	Emri i Programit	Viti 2024			Viti 2025			Viti 2026		
		Tavani i programit	Shpenzime Korrente	Shpenzime Kapitale	Tavani i programit	Shpenzime Korrente	Shpenzime Kapitale	Tavani i programit	Shpenzime Korrente	Shpenzime Kapitale
AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse	127,982	122,573	5,409	126,817	124,715	2,102	128,982	127,982	2,000
AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile	534,940	349,940	185,000	564,039	358,039	206,000	584,100	367,100	216,000
AC102	Arsimi & Kujdesi Social	373,742	371,242	2,500	379,947	374,947	5,000	387,001	380,001	7,000
AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore	41,373	41,373	-	41,787	41,787	-	42,205	42,205	-
AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	70,326	70,326	-	71,029	71,029	-	73,078	72,078	1,000
AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet	115,639	109,639	6,000	115,581	112,717	2,864	119,285	116,285	3,000
AG102	Rezerva & Kontigjenca	6,000	6,000	-	6,000	6,000	-	10,000	10,000	-
TOTALII TAVANEVE PËRGATITORE		1,270,002	1,071,093	198,909	1,305,200	1,089,234	215,966	1,344,651	1,115,651	229,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Drejtoritë dhe ndërmarrjet e varësisë do të përgatisin kërkesat shtesë brenda muajit prill të cilat do t'i paraqiten Kryetarit të Bashkisë.

Bashkëlidhur materialit është pasqyra e planit financiar të Bashkisë Berat për PBA 2024-2026 si dhe tavanet përgatitore të PBA 2024-2026.

Drafti i parë i plotë do të paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak brenda muajit Qershor 2023.

Ju faleminderit !

GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Ervin	DEMO	Kryetar i Bashkisë (NA)
Arisa	TOSKA	Sekretar i Përgjithshëm (Koordinator)
Rovena	SHEHU	Drejtor i Menxhimit Financiar dhe të Ardhurave (Sekretar i GMS)
Luçiano	BOJAXHIU	N/Kryetar i Bashkisë
Arjan	SHKËMBI	N/Kryetar i Bashkisë
Luçiano	BOJAXHIU	Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve
Etleva	DHIMA	Drejtor i Integritimit European dhe Planifikimit Strategjik
Sokol	TOSKA	Drejtor i Taksave dhe Tarifave
Gentian	DASHI	Drejtor i Burimeve Njerëzore
Petro	SINJARI	Drejtor i Drejtorisë Juridike
Erlin	KUÇI	Drejtor i Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve
Silvana	MERDANI	Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve
Kreshnik	ZAIMI	Drejtor i Policisë Bashkiake
Artan	MERKO	Drejtor i repartit të MZSH
Piro	XHEBLATI	Drejtor i Shërbimit Social
Majlinda	RAMA	Drejtor i Arsimit, Kulturës dhe Rinisë
Bledar	ÇILI	Drejtor i NJSH Agjencia së Shërbimeve Publike
Arjan	SHKËMBI	Drejtor i NJSH Drejoria e Bujqësisë, administrim pyje, ujëra e shërbim veterinar
Klodiana	HOXHA	Drejtor i NJ.SH. Drejtoria Arsimore
Arben	QAFI	Drejtor i NJ.SH. Qendra Kulturore “ Margarita Tutalani”
Alma	KULE	Drejtor i NJ.SH. Qendra “LIRA”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK